

## INFORMATA MBI GRANTIN

Emri i grantit:	Nxitja e reflektimit kritik mbi çështjet urgjente përmes praktikave të artit bashkëkohor
Instrumenti:	Grant i mesëm për projekt
Subjekti zbatues:	Shtatëmbëdhjetë (17)
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rr. Henrik Bariç, nr.5, 10000, Prishtinë <a href="mailto:contact@foundation17.org">contact@foundation17.org</a> +383 49 170 078 <a href="http://www.foundation17.org">http://www.foundation17.org</a>
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 01/09/2022 Data e përfundimit: 31/08/2023
Buxheti total i grantit (EUR):	79,688.00 EUR
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	39,200.00 EUR
Grupet e synuara:	Gra dhe burra (të rinj/reja), artistë/e dhe student/e të arteve , aktivistë/e të të drejtave të njeriut, komunitete të praktikës, Qytetarë
Shtrirja gjeografike:	Prishtinë
Përmbledhje e grantit:	<p>Qëllimi i përgjithshëm i programit është të nxisë reflektimin kritik duke identifikuar dhe mbështetur zëra të guximshëm që mundësojnë perspektiva të reja mbi çështjet aktuale lokale dhe rajonale përmes praktikave të artit bashkëkohor. Objektivat specifike janë të organizuara rreth dy qëllimeve kryesore të veçanta: 1. Ofrimi i mundësive për zhvillim kreativ duke mbështetur artistë/e dhe aktivistë/e në zhvillim të të gjitha gjinive, duke ndërtuar kapacitetet e tyre dhe duke i lehtësuar ata/o për të trajtuar çështjet urgjente socio-ekonomike dhe mjedisore në Kosovë dhe rajon përmes praktikave të artit bashkëkohor. 2. Ofrimi i programeve të aktivizmit kulturor të fokusuar në çështjet urgjente në Kosovë që nxisin reflektimin, dialogun dhe angazhimin publik që i shërbejnë ndryshimeve pozitive socio-kulturore në vend. Nëpërmjet programit të propozuar Shtatëmbëdhjetë (17) do të investojë në përmirësimin dhe drejtimin e programeve alternative që konsistojnë në programin e ngritjes së kapaciteteve, ligjëratat publike, master klasa dhe rezidenca; komisionimin e prodhimit të veprave artistike dhe përmbajtjes për trajtimin e temave që lidhen me trajtimin e çështjeve urgjente socio-ekonomike dhe mjedisore në rajon; dhe drejtimin e një programi publik tematik të qasshëm për të gjithë, i fokusuar në temat e programit paralelisht në Project Space 17, <a href="#">Galeria 17</a>, dhe Rezidenca 17.</p>

Bashkëfinancuar nga: